



FEDERATA E HENDBOLLIT E KOSOVËS

KOSOVA HANDBALL FEDERATION

RUKOMETNI SAVEZ KOSOVA

RREGULLORJA MBI PUNËN E KOMISIONIT ARBITRAR TË FHK-së

**Prishtinë,
01.10.2022**

Në bazë të nenit 6 dhe 10 të Statutit të Federatës së Hendbollit të Kosovës, Bordi i FHK-së në mbledhjen e vet të mbajtur më 01.10.2022 miraton aktin normativ

RREGULLORJA MBI PUNËN E KOMISIONIT ARBITRAR TË FHK-së

Neni 1

Me këtë rregullore, rregullohen statusi dhe procedura pranë Komisionit Arbitrar të Federatës së hendbollit të Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm 'Arbitrazhi').
Selia e Arbitrazhit është në Prishtinë, në selinë e Federatës së Hendbollit të Kosovës (në tekstin e mëtejme FHK).

Neni 2

Komisionin Arbitrar e zgjedh dhe e shkarkon Bordi i FHK-së. Mandati i Komisionit Arbitrar zgjatë 4 vite.

Neni 3

Komisioni Arbitrar (në tekstin e mëtutjeshëm Arbitrazhi) përbëhet prej tre (3) anëtarëve, Kryetarit dhe dy anëtarëve.

Neni 4

Kryetari i Arbitrazhit, kryeson dhe udhëheqë me punën e arbitrazhit, si dhe përcakton personin (anëtarin e arbitrazhit), i cili do të hartojë Vendimet e Arbitrazhit. Vota e Kryetarit është e barabartë me e atë të anëtarëve.
Në mbledhjet e Arbitrazhit mund të merr pjesë edhe Sekretari i Përgjithshëm i FHK-së, mirëpo, vetëm në cilësinë këshill-dhënëse dhe pa të drejtë vote ose vendim marrjeje.

Neni 5

Arbitrazhi vendos për çështje statusore, ku përfshihen:

- Anëtarësia e klubeve dhe shoqatave në FHK-së
- Statusi i lojtarëve
- Kontestet e transferimeve të lojtarëve ose regjistrimit të lojtarëve
- Kontestet kontraktuale klub - lojtar
- Kontestet ndërmjet klubeve ose anëtarëve të FHK-së, Arbitrazhi, po ashtu, vendos në shkallë të dytë në rast të ankesave:

- Në vendimet e Komisionit për Kalim dhe Regjistrim

Neni 6

Ankesa në Vendimet e Komisioneve nga neni 5 i kësaj Rregulloreje parashtrohet me shkrim sipas Rregullores mbi regjistrimin e klubeve, lojtarëve, transferimi dhe statusi i tyre duhet të përmbajë:

- Emërtimin e personit që ankohet.
- Bazën juridike të ankimit.
- Faktet në të cilat mbështetet ankesa (provat materiale) dhe
- Të saktësohet se i drejtohet Arbitrazhit të FHK-së.

Neni 7

Pala e cila ankohet, duhet ta paguaj taksën e caktuar sipas Rregullores mbi regjistrimin e klubeve, lojtarëve, statusi dhe transferimi i tyre.

Pavarësisht prej miratimit apo jo të ankesës së parashtruar taksa në vlerën e paguar nuk i kthehet ankuesit.

Në qoftë se ankesa aprovohet, shuma e mbetur e të hollave i kthehen ankuesit (pasi të përmbushën obligimet nda Komisionit). .

Neni 8

Klubet të cilat parashtrojnë ankesë, mundën që në procedurë të përfaqësohen edhe nga personat e autorizuar, të cilët nuk janë përfaqësues zyrtar të klubeve.

Të drejtën nga paragrafi i këtij neni e kanë edhe personat e tjerë të cilët kanë të drejtë të ankohen në Arbitrazh.

Neni 9

Arbitrazhi duhet të bie vendim, në afatet e përcaktuara në Aktet normative të FHK-së, Rregullores disiplinore dhe Rregullores mbi regjistrimin e klubeve, lojtarëve, statusi dhe transferimi i tyre.

Në qoftë se nuk është prezent njëri anëtar i Arbitrazhit, ai mund të deklarohet me shkrim, në lidhje me ankesën nëpër nëpërmjet postes elektronike.

Vendimi i Arbitrazhit duhet të përmbajë:

- Emrin e plotë të lëndës
- Përbërjen e Arbitrazhit
- Përshkrimin e procesit të trajtimit të lëndës
- Vendimin

- Arsyetimin

Neni 10

Arbitrazhi gjatë punës së vet, duhet të vendos në bazë të parimit të çmuarjes së lirë të provave, akteve normative të FHK-ës dhe ligjeve të aplikueshme në Kosovë. Gjatë trajtimit të lëndës, Arbitrazhi mund të vendosë për:

- Anulimin – në rast se lënda është dorëzuar jashtë afateve, nuk është bërë pagesa sipas nenit 7, nuk është dorëzuar nga personat e pa autorizuar ose nuk përbën lëndë për arbitrazh.
- Refuzimin e ankesës/kërkesës – rrjedhimisht konfirmimin e vendimit të shkallës së parë.
- Miratimin e ankesës/kërkesës – dërgimin në rishqyrtim të lëndës në shkallën e parë
- Miratimin e ankesës/kërkesës – anulimin e vendimit të shkallës së parë.

Neni 11

Arbitrazhi gjatë marrjes së vendimeve, duhet të përdorë vulën katrore dhe atë të rrumbullakët të FHK-ës. Mbledhjet e Komisionit Arbitrar i thërret Sekretari i FHK-së.

Neni 12

Vendimet e arbitrazhit janë definitive, dhe kundër tyre nuk është e lejuar ankesa.

Neni 13

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i FHK-së.

Prishtinë,
01.10.2022



BORDI I FHK-së,
Eugen Saraçini
EUGEN SARAÇINI

President